

URDHËR
Nr. 433, datë 10.9.2024

**PËR NDËRPRERJEN E FUNKSIONIT TË ANËTARIT TË KOMISIONIT
DISIPLINOR TË PËRMBARUESVE GJYQËSORË PRIVATË, TË Z. ERIND
MËRKURI**

Në mbështetje të nenit 102, pika 4, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; të nenit 7, pika 2, të ligjit nr. 8678, datë 14.5.2001, “Për organizimin dhe funksionimin e Ministrisë së Drejtësisë”, të ndryshuar; të shkronjës “b”, të pikës 1, dhe të pikave 2, 7 dhe 9, të nenit 73 të ligjit nr. 26/2019, “Për Shërbimin Përmbartimor Gjyqësor Privat”; si dhe të urdhrit të ministrit të Drejtësisë nr. 197, datë 26.6.2020, “Për miratimin e rregullave të hollësishme për paraqitjen dhe trajtimin e shprehjeve të interesit, si dhe verifikimin e plotësimit të kushteve ligjore për anëtar të Komisionit Disiplinor të Përmbartuesve Gjyqësor Privat”,

KONSTATOJ:

Me urdhrin nr. 399, datë 26.11.2020, “Për zgjedhjen e anëtarit të Komisionit Disiplinor të Përmbartuesve Gjyqësorë Privatë”, z. Erind Mërkuri është zgjedhur anëtar i Komisionit Disiplinor të Përmbartuesve Gjyqësorë Privatë. Mandati si anëtar i Komisionit Disiplinor të Përmbartuesve Gjyqësorë Privatë i ka filluar më datë 1.12.2020, me afat përfundimi më datë 30.11.2024.

Me shkresën e protokolluar pranë Ministrisë së Drejtësisë me nr. E-348 prot., datë 23.7.2024, z. Erind Mërkuri ka njoftuar dorëheqjen, me arsyetimin se, meqenëse si përfaqësues i shoqërisë civile, nga hedhja e shortit është vendosur që emri i tij t’i propozohet seancës plenare të Kuvendit, për t’u zgjedhur si anëtar i Këshillit të Lartë të Prokurorisë.

Referuar vendimit nr. 69/2024, “Për zgjedhjen e anëtarëve të Këshillit të Lartë të Prokurorisë nga radhët e avokatëve, sipas ligjit nr. 115/2016, ‘Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë’”, i ndryshuar, të Kuvendit të Republikës së Shqipërisë, botuar në Fletoren Zyrtare nr. 129, datë 26.7.2024, z. Erind Mërkuri është zgjedhur anëtar i Këshillit të Lartë të Prokurorisë.

PËR KËTO ARSYE:

Në mbështetje të nenit 102, pika 4, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; të nenit 7, pika 2, të ligjit nr. 8678, datë 14.5.2001, “Për organizimin dhe funksionimin e Ministrisë së Drejtësisë”, të ndryshuar; të shkronjës “b”, të pikës 1, dhe të pikave 2, 7 dhe 9, të nenit 73, të ligjit nr. 26/2019, “Për Shërbimin Përmbartimor Gjyqësor Privat”; si dhe të urdhrit të ministrit të Drejtësisë nr. 197, datë 26.6.2020, “Për miratimin e rregullave të hollësishme për paraqitjen dhe trajtimin e shprehjeve të interesit, si dhe verifikimin e plotësimit të kushteve ligjore për anëtar të Komisionit Disiplinor të Përmbartuesve Gjyqësorë Privatë”,

URDHËROJ:

1. Ndërprerjen e funksionit, si anëtar i Komisionit Disiplinor të Përmbartuesve Gjyqësorë Privatë, të z. Erind Mërkuri.

2. Ngarkohet Sektori i Arkiv-Protokollit për marrjen e masave dhe njoftimin e këtij urdhri z. Erind Mërkuri, Dhomës Kombëtare të Përmbartuesve Gjyqësorë Privatë, si dhe Shkollës së Magjistraturës.

3. Ky urdhër publikohet në faqen zyrtare të Ministrisë së Drejtësisë dhe në Buletinin e Njoftimeve Zyrtare të Republikës së Shqipërisë.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

MINISTËR I DREJTËSISË
Ulsi Manja